FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 29	2000	Shtator

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM Nr.489, datë 19.9.2000	Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, gjithsej 94 për qind, të zotëruar nga shteti, në "Birra Malto" sh.a, Tiranë dhe shpalljen fitues të tenderit të "Birra Peroni industriale" s.p.a	1463
Vendim i KM Nr.490, datë 19.9.2000	Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, prej 88 për qind, të zotëruar nga shteti, në prodhime farmaceutikë sh.a, Tiranë dhe shpalljen fitues të tenderit të "Aldosch", sh.p.k	1463
Vendim i KM Nr.491, datë 19.9.2000	Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve (90 për qind), të zotëruara nga shteti në "Qumështi Ajka", sh.a, Tiranë dhe shpalljen fitues të tenderit të "Aldosch", sh.p.k	1464

Vendim i KM Nr.492, datë 19.9.2000	Për miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, gjithsej 76 për qind, të zotëruara nga shteti, në "Kantina e Pijeve "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"", sh.a, dhe shpalljen fitues të tenderit "Rilindja" sh.p.k.....	1465
Vendim i KM Nr.493, datë 19.9.2000	Për mënyrën e shpërndarjes së përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë.....	1466
Vendim i KM Nr.494, datë 19.9.2000	Për një shtesë në vendimin nr.400, datë 27.7.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e privatizimit të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë".....	1467

V E N D I M
Nr.489, datë 19.9.2000

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË TENDERIMIT, PËR SHITJEN E PAKETËS SË AKSIONEVE, PREJ 88 PËR QIND, TË ZOTËRUARA NGA SHTETI, NË "PRODHIME FARMACEUTIKE", SH.A., TIRANË, DHE SHPALLJEN FITUES TË TENDERIT TË "ALDOSCH", SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit", të paragrafit të dytë, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohen nga shteti", ndryshuar me vendimet nr.122, datë 18.3.2000, nr.179, datë 13.4.2000 dhe nr.456, datë 17.8.2000, të Këshillit të Ministrave, si dhe të vendimit nr.463, datë 6.10.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e tenderit, si formë të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", ndryshuar me vendimin nr.123, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, prej 88 për qind, të zotëruara nga shteti, në "Prodhime farmaceutike", sh.a., Tiranë, dhe shpalljen fitues të tenderit të "Aldosch", sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Tiranë, të lidhë kontratën e shitjes së paketës së aksioneve të "Prodhime farmaceutike", sh.a., Tiranë, me fituesin e tenderit "Aldosch", sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.490, datë 19.9.2000

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË TENDERIMIT, PËR SHITJEN E PAKETËS SË AKSIONEVE, GJITHSEJ 76 PËR QIND, TË ZOTËRUARA NGA SHTETI, NË "KANTINA E PIJEVE "GJERGJ KASTRIOTI SKËNDERBEU"", SH.A. DURRËS, DHE SHPALLJEN FITUES TË TENDERIT "RILINDJA", SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit", të paragrafit të dytë, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohen nga shteti", ndryshuar me vendimet nr.122, datë 18.3.2000, nr.179, datë 13.4.2000 dhe nr.456, datë 17.8.2000, të Këshillit të Ministrave, si dhe të vendimit nr.463, datë 6.10.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e tenderit, si formë të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", ndryshuar me vendimin nr.123, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, gjithsej 76 për qind, të zotëruara nga shteti, në "Kantina e Pijeve, "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"", sh.a., Durrës, dhe shpalljen fitues të tenderit të "Rilindja", sh.p.k.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit, Tiranë, të lidhë kontratën e shitjes së paketës së aksioneve të "Kantina e pijeve "Gjergj Kastrioti Skënderbeu"", sh.a., Durrës, me fituesin e tenderit "Rilindja", sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.491, datë 19.9.2000

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË TENDERIMIT, PËR SHITJEN E PAKETËS SË AKSIONEVE, GJITHSEJ 94 PËR QIND, TË ZOTËRUAR NGA SHTETI, NË "BIRRA MALTO", SH.A., TIRANË, DHE SHPALLJEN FITUES TË TENDERIT TË "BIRRA PERONI INDUSTRIALE", S.P.A.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit", të paragrafit të dytë, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohen nga shteti", ndryshuar me vendimet nr.122, datë 18.3.2000, nr.179, datë 13.4.2000 dhe nr.456, datë 17.8.2000, të Këshillit të Ministrave, si dhe të vendimit nr.463, datë 6.10.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e tenderit, si formë të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", të ndryshuar me vendimin nr.123, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, gjithsej 94 për qind, të zotëruara nga shteti, në "Birra Malto", sh.a., Tiranë, dhe shpalljen fitues të tenderit të "Birra Peroni Industriale", S.p.a.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit Tiranë të lidhë kontratën e shitjes së paketës së aksioneve të "Birra Malto", sh.a, Tiranë, me fituesin e tenderit "Birra Peroni Industriale", S.p.a.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.492, datë 19.9.2000

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË TENDERIMIT, PËR SHITJEN E PAKETËS SË AKSIONEVE (90 PËR QIND), TË ZOTËRUARA NGA SHTETI NË "QUMËSHTI AJKA", SH.A., TIRANË, DHE SHPALLJEN FITUES TË TENDERIT TË "ALDOSCH" SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3, të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private, të pavarura dhe privatizimit", të paragrafit të dytë, të nenit 3, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998, "Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", të vendimit nr.529, datë 21.8.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e tenderimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që zotërohen nga shteti", ndryshuar me vendimet nr.122, datë 18.3.2000, nr.179, datë 13.4.2000 dhe nr.456, datë 17.8.2000, të Këshillit të Ministrave, si dhe të vendimit nr.463, datë 6.10.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për caktimin e tenderit, si formë të privatizimit të paketave të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë", ndryshuar me vendimin nr.123, datë 18.3.2000, të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurës së tenderimit, për shitjen e paketës së aksioneve, prej 90 për qindsh, të zotëruara nga shteti, në "Qumështi Ajka", sh.a., Tiranë, dhe shpalljen fitues të tenderit të "Aldosch", sh.p.k.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit të lidhë kontratën e shitjes së paketës së aksioneve te "Qumështi Ajka", sh.a., Tiranë, me fituesin e tenderit "Aldosch", sh.p.k.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.493, datë 19.2.2000

PËR MËNYRËN E SHPËRNDARJES DHE TË PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE NGA PRIVATIZIMI I NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇIMENTOS, FUSHË-KRUJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20, të ligjit 7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", me ndryshimet përkatëse të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998, "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.8554, datë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe të ministrit të Punëve Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ardhurat nga privatizimi i ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë, të përdoren si më poshtë:

a. 5 për qind të përdoren nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, për përballimin e shpenzimeve për privatizimin e ndërmarrjeve dhe shoqërive tregtare.

b. 2 për qind të përdoren nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit për përballimin e shpenzimeve gjatë procedurave të tenderit dhe për shpërblimin e komisionit të vlerësimit të ofertave.

c. Ministrisë së Punëve Publike i kalohet fondi prej 125 200 000 lekësh, për kryerjen e pagesave të prapambetura, në masën 60 për qind të pagës mesatare, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 1999 dhe 1 janar – 31 gusht 2000. Pas kësaj date punonjësit që përfitojnë të trajtohen me pagesë papunësie, sipas legjislacionit në fuqi.

Ç. Institutit të Sigurimeve Shoqërore i kalohet fondi prej 100 461 000 lekësh për pagesat e sigurimeve shoqërore për të gjithë punonjësit, për vitet 1997, 1998, 1999 deri 31.8.2000, brenda një muaji, nga arkëtimi i të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes.

2. Pjesa e mbetur e të ardhurave të siguruara nga privatizimi i ndërmarrjes, pas shpërndarjes sipas shkronjave a, b, c, dhe ç të pikës 1 të këtij vendimi, të derdhet në buxhetin e shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Punëve Publike dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

V E N D I M
Nr.494, datë 19.9.2000

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.400, DATË 27.7.2000, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇIMENTOS FUSHË-KRUJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 23 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive të pavarura dhe privatizimin", nenit 4, shkronja "ç", të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995, "Për shitblerjen e trojeve", të vendimit nr.408, datë 31.8.1999, të Këshillit të Ministrave "Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore" dhe të vendimit nr.433, datë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin me tender të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Nw vendimin nr.400, datë 27.7.2000, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"Nënshkrimi i kontratës së shitjes së ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë do të kryhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

U dorëzua për shtyp më 20.9.2000
Doli nga shtypi më 20.9.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi: 100 lekë